Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 26 tetor 2011

Lënda nr. 59/10

AGJENCIA PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 26 tetor 2011,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve, duke përfshirë edhe ato përmes mjeteve elektronike, në pajtim me Rregullën 13 § 2 të Rregullores së punës, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u paraqit më 30 mars 2010 dhe u regjistrua më 1 prill 2010. Në procedurën pranë Panelit, ankuesi është i përfaqësuar nga z. Nikola Radosavović, një avokat që punon në Beograd, Serbi.

II. FAKTET

2. Ankuesi është Agjencia për Sigurimin e Depozitave, një agjenci publike sipas ligjeve të Republikës së Serbisë. Zyrën qendrore e ka në Beograd, Serbi.

3. Ankuesi pohon se është ngritur padi kundër ndërmarrjes në pronësi shoqërore Ferronikel dhe Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme) më 17 korrik 2006, duke kërkuar pagesën e borxheve që Ferronikeli kishte ndaj ankuesit si dhe pagesën e kompensimit nga AKM-ja.

4. Ankuesi thekson se, pasi ka mësuar se ishte iniciuar procedurë për likuidimin e Ferronikelit, AKM-së ia paraqiti regjistrat e të arkëtueshmeve më 12 shtator 2006.

5. Ankuesi pohon se Dhoma e Posaçme nuk kishte marrë asnjë vendim lidhur me padinë e paraqitur nga ankuesi.

III. ANKESA

6. Ankuesi ankohet për shkeljen e të drejtave të tij për të marrë vendim për rastin brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. LIGJI

7. Para se të shqyrtohet bazueshmëria e rastit, Paneli së pari duhet të vendosë nëse do ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret për pranim të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

8. Sipas nenit 1.2 të Rregullores, Paneli ka juridiksion për ankesat e paraqitura "nga cilido person apo grup individësh" të cilët pohojnë se janë viktima të shkeljes së të drejtave të njeriut të kryera nga UNMIK-u.

9. Paneli thekson se ankuesi ka statusin e agjencisë publike sipas Ligjit të Agjencisë për Sigurimin e Depozitave të Republikës së Serbisë (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë*, nr. 61/2005). Paneli është i mendimit se referenca në ankesat e paraqitura nga cilido person apo grup individësh në nenin 1.2 të Rregullores nuk mund të interpretohet ashtu që të përfshijë ankesat e parashtruara nga shteti apo nga cilado agjenci e tij.

10. Prandaj, Paneli konsideron se ankesa është jashtë juridiksionit të tij *ratione personae*.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

E SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar